

VENDIM
Nr. 842, datë 26.12.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 31, DATË 22.1.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR ORGANIZIMIN, PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE
STATUSIN E AUTORITETIT TË KONTROLLIT SHTETËROR TË
EKSPORTEVE, PËRCAKTIMIN E AFATEVE, TË MËNYRËS DHE TË
PROCEDURËS PËR SHKËMBIMIN E INFORMACIONIT DHE TË MARRJES SË
MENDIMIT NGA INSTITUCIONET E TJERA TË PËRFSHIRA NË
TRANSFERIMET NDËRKOMBËTARE TË MALLRAVE TË KONTROLLUARA, SI
DHE PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE PËR LËSHIMIN E GARANCIVE DHE
KRYERJEN E KONTROLLIT SHTETËROR”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 9, pika 4, e 35, pika 8, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në kreun IV, të vendimit nr. 31, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për organizimin, përbërjen, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, përcaktimin e afateve, të mënyrës dhe të procedurës për shkëmbimin e informacionit dhe të marrjes së mendimit nga institucionet e tjera të përfshira në transferimet ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara, si dhe përcaktimin e procedurave për lëshimin e garancive dhe kryerjen e kontrollit shtetëror”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 29, fjalë e dytë “Kriteret për lëshimin e certifikatave përcaktohen me urdhër të kryetarit të AKSHE-së, në përputhje me pikën 3, të nenit 26, të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë””, hiqet.

2. Në pikën 32, fjalët “... dhe ligjin nr. 10433, datë 16.6.2021, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”...” zëvendësohen me “...dhe legjislacionin në fuqi për inspektimin në Republikën e Shqipërisë...”.

II. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama